IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Mars 2026

Zbulohet një vendbanim i ri arkeologjik në zonën e Lushnjes

Qyteti i Delvinës Shpallet Pasuri Kulturore e paluajtshme

Bylis/Klos; Projekti i Qendrës së re Multifunksonale

Ditët Europiane të Arkeologjisë, Romë, Itali

Inspektim mbi rrënojat e një kishe mesjetare, Çorovodë

Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut, Himarë

Ura e Katiut, Përmet

Piktura murale dhe ikonostasi; Kisha në Manastirin e Ungjillizimit, Vanistër, Gjirokastër

Mozaiku i Kishës Paleokristiane të Antigonesë

Kisha e Shën Gjergjit, Suk, Roskovec

Restaurimi i mureve antike, Durrës

Botimi nr. 03
IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Zbulohet një vendbanim i ri arkeologjik në zonën e Lushnjes.

Arkeologët e IKTK-së, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, po kryejnë gërmime arkeologjike shpëtimi në vendin e quajtur Kodra e Pusit, pranë fshatit Murizë-Peqin.

Gërmimet kanë zbuluar gjurmët e një vendbanimi të rëndësishëm me kohështrirje nga periudha romake deri në antikitetin e vonë.
Hulumtimet do të vijojnë për të pasuruar njohuritë mbi historinë dhe zhvillimin e kësaj zone.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Qyteti i Delvinës Shpallet Pasuri Kulturore e paluajtshme

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale shpall qytetin e Delvinës pasuri kulturore të paluajtshme, në kategorinë “Ansambël Arkitektonik Urban”, duke vlerësuar rëndësinë e veçantë historike, arkitektonike dhe urbanistike të këtij qyteti, si dhe duke synuar mbrojtjen, ruajtjen, konservimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet këtij statusi synohet jo vetëm ruajtja e identitetit historik dhe kulturor të qytetit, por edhe nxitja e zhvillimit të turizmit kulturor, promovimi i ndërhyrjeve restauruese dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e trashëgimisë kulturore si një aset i çmuar kombëtar.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Bylis/Klos
Projekti i Qendrës së re Multifunksonale

Parku Arkeologjik i Bylisit dhe Klosit po hyn në një fazë të re zhvillimi, me një qasje të integruar që synon ta kthejë këtë pasuri të rrallë në një eksperiencë të plotë kulturore dhe turistike. Projekti, i mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe qeveria italiane, parashikon ngritjen e një Qendre të re Multifunksionale, hartimin e një Master Plani të pikave të interesit, si dhe përmirësimin e aksesit, parkimit dhe sigurisë në park.



Qendra Multifunksionale konceptohet si një hapësirë dinamike që ndërthur funksione muzeale dhe interpretimi, sallë për aktivitete kulturore, kënd informacioni, librari e suvenire, kafeteri, laborator konservimi dhe ambiente shërbimi për vizitorë e personel, duke e kthyer Bylisin dhe Klosin nga një sit arkeologjik në një eksperiencë të plotë kulturore, edukative dhe turistike.
Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në bashkëpunim me IKTK dhe partnerin ndërkombëtar AICS, synon jo vetëm konservimin e trashëgimisë, por edhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës përmes turizmit dhe kërkimit shkencor.

Në mbledhjen e KKTU u miratua Leja e Zhvillimit për projektin dhe investimin që fillon së shpejti. MTKS po përmbyll punën për aktet nënligjore që janë tashmë gati për aspektin administrativ e menaxhues.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Ditët Europiane të Arkeologjisë
Romë, Itali

Në ambientet e Museo Ninfeo, në Romë , më 25 – 26 Mars 2026 u zhvillua forumi “Ditët Europiane të Arkeologjisë”, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Italisë, duke sjellë në fokus qasje të reja për afrimin e arkeologjisë me publikun.

Nisma, e udhëhequr nga Instituti Kombëtar i Kërkimeve për Arkeologjinë Preventive (INRAP), bashkon institucionet kryesore europiane, ndërsa Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është pjesë aktive e kësaj nisme.

Në këtë kuadër, IKTK do të organizojë edhe në Shqipëri Ditët Europiane të Arkeologjisë 2026, më 13 –15 Qershor 2026, paralelisht me vendet e tjera europiane.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim mbi rrënojat e një kishe mesjetare, Çorovodë

Në kuadër të verifikimit të interesit kulturor, specialistët e IKTK-së kryen një inspektim në terren mbi rrënojat e një kishe mesjetare të ndodhura në banesën e Mylazim Sulçes në Çorovodë. Rrënojat, të zbuluara gjatë ndërtimit të banesës në vitin 1993, ruhen pjesërisht në katin përdhe dhe përfshijnë fragmente muresh, pilastra dhe gjurmë afreskesh, megjithëse konteksti arkeologjik është dëmtuar nga ndërhyrjet ndërtimore.

Bazuar në elementët arkitektonikë, kisha mendohet të ketë pasur planimetri të tipit kryq i brendash-kruar me kupolë. Në zonë janë identifikuar edhe varre, disa prej të cilave të dëmtuara, që lidhen me funksionin e objektit. Pavarësisht gjendjes së dëmtuar, rrënojat paraqesin vlera të rëndësishme arke-ologjike dhe historike.

Qëllimi i këtij inspektimi është vlerësimi i tyre për shpallje si pasuri kulturore, duke kontribuar në plotë-simin e kuadrit të zhvillimit dhe shtrirjes së kultit të krishterë në këtë zonë, si një territor kufitar me Be-ratin dhe Korçën, ku ky kult ka njohur një zhvillim të rëndësishëm historik.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim: Miratohet projekti për restaurimin e Kishës së Shën Sergjit dhe Bakut, Himarë

Projekti konsiston në restaurimin dhe konservimin e kishës së Shën Sergjit dhe Bakut në Himarë, duke synuar ruajtjen e vlerave historike dhe arkitektonike të saj, si dhe përmirësimin e gjendjes fizike të monumentit.







Në thelb, ndërhyrjet përfshijnë:

- Konsolidimin strukturor të objektit (muret, çarjet, themelet)
- Restaurimin e çatisë, dyshemesë dhe elementeve të dëmtuara;
- Trajtimin e lagështisë dhe degradimit të materialeve;
- Pastrimin nga vegjetacioni dhe mbeturinat;
- Restaurimin e narteksit, naosit dhe hapësirave përreth;
- Përmirësimin e kushteve funksionale dhe vizuale të monumentit për vizitorët.

Qëllimi kryesor i projektit është stabilizimi i monumentit, ndalimi i degradimit të mëtejshëm dhe rikthimi i tij si një vlerë e rëndësishme kulturore dhe turistike.

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Miratohet projekti :
“Restaurm, Ura e Katiut, Bënjë, Përmet.”

Projekti konsiston në restaurimin dhe konsolidimin e Ura e Katiut në Bënjë, Përmet, monument kulture i kategorisë së parë. Ndërhyrja synon stabilizimin strukturor të urës, veçanërisht në këmbën e djathtë ku janë evidentuar dëmtime serioze nga gërryerja si pasojë e prurjeve të larta ujore.



Punimet përfshijnë pastrimin nga vegjetacioni, restaurimin e kalldrëmit, fugatimin me llaç gëlqereje, konsolidimin e gurëve të dëmtuar, si dhe përforcimin e themelit dhe veshjen e elementëve të ekspozuar.

Projekti synon eliminimin e faktorëve të degradimit, ruajtjen e vlerave historike dhe arkitektonike të urës, si dhe rritjen e potencialit për zhvillimin e turizmit kulturor në zonë.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Miratohet projekti i ndërhyrjes konservuese-restauruese në pikturën murale dhe ikonostasin e kishës në Manastirin e Ungjillizimit, Vanistër – Gjirokastër

Manastiri i Ungjillëzimit të Hyjlindëses është një kompleks fetar ortodoks i vendosur mbi fshatin Vanistër, në Luginën e Drinos, në Dropull të Gjirokastrës. Piktura murale është e realizuar në dy faza; Faza e I në 1617 nga Mihal Linotopi dhe përfshin pikturën në naos, një pjesë të narteksit dhe ekso-narteksin, ndërsa faza e II nga Jani nga Qestorati në vitin 1758.

Ndërhyrjet konservuese/restauruese që propozohen;

- Konsolidimi i pelikulit dhe fiksimi i tij
- Ringjitja e shtresës së (ariccios) me murin (xhepa)
- Ringjitja e shtresës së intonacos me ariccion
- Ringjitja e shtresës së pelikulit me intonacon
- Çlirimi i shtresës së suvasë së pikturuar nga lyerjet me gëlqere
- Pastrimi i sipërfaqes së afrekut nga pluhurat
- Pastrimi i sipërfaqes së afreskut nga bloza dhe tymi i depozituar në vite
- Pastrimi nga mbeturinat vajore të vernikut, rrjedhjes së qirinjve etj.
- Pastrimi i sipërfaqes së afreskut nga kripërat e kalciumit të depozituara në formë shtrese dhe në formë velature.
- Pastrimin nga suva-stukimet dhe bordurimet e kryera pa kujdes
- Stukimin dhe bordurimet e reja me llaç të tonuar
- Integrimi me ngjyrë i pikturës







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Miratohet projekti i konservim-restaurimit të Mozaikut të Kishës Paleokristiane të Antigonesë

Mozaiku dekoron dyshemenë e ambientit të altarit. Ai ka një formë ovale, si dhe vetë ambienti. Mozaiku ka përmasa 7.80 x 3.80 m, me sipërfaqe totale prej rreth 30 m2, i realizuar në teknikën opus tessellatum.

Ndërhyrjet konservuese -restauruese pas hapjes së mozaikut, do të synojnë trajtimine problematikave kryesore:

- Ritrajtim i lakunave
- Rivendosje e teserave
- Ribërje e bordurimeve
- Trajtim i çarjeve
- Pastrim i depozitimeve sipërfaqsore (me natyrë biologjike, të natyrave të tjera)

Në përfundim të ndërhyrjeve konservuese-restauruese, synohet të arrihet një përmirësim i gjendjes së mozaikut në tërësi.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim:
“Rishikim i projektit të Kishës së Shën Gjergjit në fshatin Suk, Roskovec”

Ky projekt konsiston në restaurimin e Kishës së Shën Gjergjit në fshatin Suk, Roskovec, monument kulture i kategorisë së parë, e cila ndodhet në gjendje shumë të degraduar dhe ruhet pjesërisht si rrënojë. Ndërhyrja synon konservimin dhe rikthimin e qëndrueshmërisë së objektit, përmes pastrimit nga bimësia, plotësimit dhe ringritjes së muraturave, restaurimit të apsidës dhe këmbanares, ndërtimit të çatisë së naosit, përforcimeve strukturore, trajtimit të çarjeve, restaurimit të elementeve të dëmtuara arkitektonike, si dhe vendosjes së dyshemeve, tavanit dhe elementeve të drurit.

Nga shqyrtimi teknik rezulton se projekti paraqet dy variante të ndryshme ndërhyrjeje, të paqarta dhe të paspecifikuara siç duhet: një variant i referohet vetëm naosit, ndërsa tjetri përfshin të gjithë kompleksin e kishës, përfshirë hajatet dhe këmbanoren. Për këtë arsye, është kërkuar që variantet të ndahen dhe të paraqiten si dy projekte teknike më vete, në mënyrë që këshillat përkatëse të vlerësojnë dhe të miratojnë një prej tyre.









Restaurim: “Rishikim i projektit të restaurimit të mureve antike të zbuluara pranë shkollës “Eftali Koçi”, Durrës dhe rehabilitimi i hapësirës përreth





- F.V parapet druri përgjat krahut jugor të strukturës (sipas grafikës)
- F.V Tabelë informuese;
- F.V porte metalike;
- Mbjellje bari;
- Riparim i murit rrethues;
- F.V stola druri;
- F.V kosh mbeturinash prej druri;
- Hapje e portës hyrsë për të mundësuar aksesin në monument;
- Krijimi i një hapësire dedikuar fëmijëve, “Arkeologu i Vogel”
- Përmirësimi i karakteristikave mekanike: rritje e rezistencës në shtypje dhe prerje.

Ndërhyrjet restauruse te parashikuara:

- Fugatim i muraturës (me llac hidraulik ose me llac Horasan sipas rastit në varësi të materialit të ndërtimit);
- Pastrim nga bimësia e ulët në gjithë territorin e monumentit dhe përreth tij;
- Sistemi i tërritorit përreth, shtrimi i rrugicave të këmbësorve me cakëll (sipas grafikës);
- Përmirësim i nivelit të organizimit të muraturës: nevojë për të përmirësuar paretet e muraturës të realizuar në disa faza - konsolidim i bërthamës së degraduar, rimbushje e boshlliqeve dhe zëvendësim e elementëve të dëmtuar, tulla dhe fuga;
  * Qepje e çarjeve të evidentuara;
- Kosolidimi i kreut të muratures me llaç horasan (llaç me pluhut tulle shamot sipas specifikimeve teknike në projekt në vëndët ku muratura është më tullë).
- Kosolidimi i kreut të muratures me llaç hiraulik (llaç me pluhut vullkanik specifikimeve teknike në projekt në vëndët ku muratura është më gurë).
- Realizimi i sistemit të drenazhit, për largimin e ujërave sipërfaqësore më anë të venodisjes së një pompe shoqeruar me tubacionet përkatëse;